



## WORKSHOP

# DREJT NJË REGJISTRI KOMBËTAR PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA KRIMET SEKSUALE NË SHQIPËRI

6 Mars 2015, Hotel Tirana International

Organizuar nga: **CRCA Shqipëri**  
**ALO 116 - Linja Kombëtare e Telefonit të Fëmijëve**

Mbështetur nga: **Qeveria e Kanadasë**



Activity supported by the  
Canada Fund for Local Initiatives  
Activité réalisée avec l'appui du  
Fonds canadien d'initiatives locales

Canada



## Rast Studimor

Babai i një fëmije 10 vjeçar telefonon tek ALO 116 000, pasi ishte i shqetësuar për mos kthimin e djalit të tij në shtëpi prej shumë orësh. Ai shpresonte të merrte një informacion nga ALO 116, por edhe të vinte në djeni këtë shërbim për humbjen e djalit, në mënyrë që të bëhej një koordinim i menjëhershëm midis institucioneve përgjegjëse dhe një reagim të shpejtë për gjetjen e djalit të tij. ALO 116 bëri një vlerësim paraprak të rastit me synim që të luante rolin e saj si një shërbim referues drejt institucioneve dhe organizatave partnere për mbrojtjen e fëmijëve.

Disa orë më vonë, Policia raporton për gjetjen e fëmijës, ku u konstatua se ai ishte rrëmbyer nga fqinji i tij 45 vjeçar dhe nga hetimet e mëtejshme u zbulua se ai ishte abuzuar seksualisht. Fëmija u shoqërua në komisarjat edhe me praninë e psikologut për të mbledhur informacion më të zgjeruar mbi situatën e ndodhur. Pas marrjes së të gjitha dëshmive për ngjarjen, fëmija kthehet në shtëpi dhe të nesërmen vijon me ndjekjen e shkollës, sikur asgjë të mos kishte ndodhur. As fëmijës dhe as familjes nuk i ofrohet asnjë shërbim këshillimi, informimi apo fuqizimi në lidhje me ngjarjen, pavarësisht se ajo ka qenë ekstreme.

## Background

Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, abuzimi dhe neglizhimi. Kërkimet shkencore theksojnë se shfrytëzimi seksual i fëmijëve, si dhe të gjitha format e abuzimit seksual ndaj fëmijëve, përfshirë veprat penale të kryera jashtë vendit janë shkatërruese për shëndetin e fëmijëve dhe zhvillimin e tyre psiko-social. Dhuna seksuale ka një ndikim të thellë mbi individin, familjen dhe shoqërinë.

Shqipëria në 2013 raportoi një rritje të përgjithshme të të gjitha llojeve të krimeve kundër personave dhe institucioneve, krahasuar me të dhënat e viteve të mëparshme. Krimet e natyrës seksuale, veçanërisht ndaj fëmijëve dhe grave, kanë qenë vazhdimisht në rritje dhe në një periudhë prej 10 vitesh këto krime janë dyfishuar. Ato janë të pranishme në jetën e shumë fëmijëve dhe prevalenca e tyre mund të vërehet në të dhënat zyrtare të agjencive të zbatimit të ligjit, studimet e kryera për dhunën kundër fëmijëve, linjës kombëtare të telefonit të fëmijëve-ALO 116, mediave etj. Studim BECAN mbi abuzimin dhe neglizhimin e fëmijëve nënvizon se: "Në periudhën e 2010-2011, Policia e Shtetit raportoi më shumë se 300 rastë penale të cilat kërcënonuan jetën e fëmijëve, ndërsa 29 prej tyre rezultuan në vdekjen e tyre. Nga të dhënat e Policisë së Shtetit nuk bëhet me dije se sa nga këta autorë ishin prindërit, vëllezërit e motrat, familjare të rrethit tëngushtë, të rritur të tjerë apo bashkëmoshatarë."<sup>1</sup>

Shteti ka detyrimin, në bazë të Konventës së OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF), për të parandaluar dhe mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës seksuale, në të gjitha

---

<sup>1</sup> Cenko E., Hazizaj A., Haxhiymeri E., Çoku B., *Violence against Children in Albania-Balkan. Epidemiologic Study on Child Abuse and Neglect (B.E.C.A.N)*, 2013, CRCA Albania, Tirana; ALO 116, the Albanian National Child Helpline is the only available national referral service of violence against children cases.

mjediset, në familje, arsim, institucionet e paraburgimit, të përkujdesjes sociale etj. Forcat e policisë dhe institucionet publike në përgjithësi, shpesh gjenden nën shok dhe presion kur ndodhin vepra si pedofilia apo forma ekstreme të dhunës në familje, pasi nuk janë të pajisura me mekanizamt e duhet për të ndihmuar viktimat apo parandaluar ndikimin që këto forma të krimit kanë. Shpesh forcat policore dhe sistemi i drejtësisë duken të paaftë të ushtojnë pushtetin që ligji i vë në dispozicion për të mbrojtur qytetarët, në veçanti ata që janë më të pambrojturit, fëmijët. Trafikimi i fëmijëve dhe grave vazhdon ende të ndikojë një numër të konsiderueshëm të fëmijëve, djemve dhe vajzave, në rrezik të shfrytëzimit seksual dhe prostitucionit në të gjithë vendin, ndërsa numri i dënimeve kundër autorëve mbetet shumë i ulët. Korrupsioni dhe ryshfeti janë një kërcënim i vazhdueshëm në përpjekjen e forcave të policisë për të luftuar krimin në të gjithë vendin.

Në 2013, CRCA Shqipëri prezantoi të dhënat e një studimi të thelluar mbi abuzimin dhe neglizhimin e fëmijëve në Shqipëri, bazuar në një kërkim shkencor 3 vjeçar në rang vendi. I njohur si BECAN (i cili u zhvillua në 8 vende të Ballkanit) **studimi raporto i se përafërsisht 12% e fëmijëve në Shqipëri ishin viktimat të ngacmimit seksual, ndërkohë që 5% pohuan se ishin viktimat të dhunës seksuale.**<sup>2</sup>Shkalla e raportimit të ulët në organet e rendit dhe si pasojë referimi i ulët në sistemin e drejtësisë është kryesisht për shkak të turpit që akte të tilla kriminale sjellin në jetën e fëmijëve dhe familjeve të tyre.

Iniciativa “Drejt një Regjistri Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Krimet Seksuale në Shqipëri” është një përpjekje e CRCA Shqipëri dhe ALO 116, në bashkëpunim me institucionet publike dhe shoqërinë civile, për ndërgjegjësimin publik mbi krimet seksuale kundër fëmijëve dhe nevojën për ngritjen e Regjistrimit Kombëtar kundër Krimeve Seksuale ndaj Fëmijëve.

## Objektivi

Objektivi kryesor i Workshopit është të rrisë ndërgjegjësimin e autoriteteve në nivel qendror, ekspertëve, medias dhe publikut të gjërë për nevojën e krijimit të një Regjistri Kombëtar për Krimet Seksuale kundër Fëmijëve.

## Workshopi synon:

- Të jetë një forum ku të paraqiten të dhënat në lidhje me krimet seksuale ndaj fëmijëve dhe të diskutohen strategji për luftën kundër pedofilisë dhe krimeve seksuale;
- Të prezantohen të dhënat dhe studimet e deritanishme në lidhje me krimet seksuale ndaj fëmijëve;

---

<sup>2</sup>; Cenko E., Hazizaj A., Haxhiymeri E., Çoku B., *Violence against Children in Albania-Balkan. Epidemiologic Study on Child Abuse and Neglect (B.E.C.A.N)*, 2013, CRCA Albania, Tirana.

- Të kthehet në një event të përvitshëm ku të diskutohet mbi gjendjen e krimeve seksuale në Shqipëri dhe zhvillimet në fushën e politikave parandaluese dhe në luftën ndaj krimit në shoqëri;
- Të ndajë dhe konsultojë legjislacionin e nevojshëm për krijimin e "Regjistrimit Kombëtar të Krimeve Seksuale";
- Të ndajë ide me agjencitë e zbatimit të ligjit, autoritetet qeveritare dhe shoqërinë civile, si një metodologji për të garantuar që inputet e tyre janë marrë në konsideratë dhe që politikëbërësit dhe agjencitë e zbatimit të ligjit janë të pajisur me informacionin e nevojshëm për miratimin e legjislacionit të ri në parlament;
- Të rishikojë dhe diskutojë rreziqet dhe ndikimet që krimet seksuale ndaj fëmijëve kanë në komunitet, menaxhimi i këtij informacioni si dhe informacioni që i përçohet publikut për krimet, autorët dhe veprat penale ndaj fëmijëve;
- Të bëhet një mjet ndërgjegjësimi mbi impaktin që këto vepra penale shkaktojnë për shoqërinë.

## **Pjesëmarrësit**

- Parlamentarë;
- Përfaqësues të Qeverisë:
  - Ministria e Punëve të Brendshme
  - Ministria e Drejtësisë
  - Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
  - Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve
  - Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
  - Koordinator Kombëtar për Anti-Trafikimin.
- Insitucione Publike:
  - Policia e Shtetit
  - Drejtoria e Shëndetit Publik
- UNICEF Shqipëri
- Agjensitë e UN
- OJF
- Partnerë të Shoqërisë Civile



Activity supported by the  
Canada Fund for Local Initiatives  
Activité réalisée avec l'appui du  
Fonds canadien d'initiatives locales

Canada



## WORKSHOP

# DREJT NJË REGJISTRI KOMBËTAR PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA KRIMET SEKSUALE NË SHQIPËRI

06 Mars 2015, Salla TEUTA  
Hotel Tirana International

### AXHENDA

- 10.00 - 10.30** Regjistrimi i Pjesëmarrësve/Kafe
- 10.30-10.35** Fjala e Mirëseardhjes.  
**Z. Altin Hazizaj**, Drejtor Ekzekutiv, CRCA Shqipëri
- 10.35 – 11.00** Roli i Kuvendit në mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna seksuale
- **Znj. Vasilika Hysi**, Kryetare e nën/Komisionit për të Drejtat e Njeriut, nën/Kryetare e Kaukusit të të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri, Kuvendi i Shqipërisë
  - **Znj. Albana Vokshi**, Deputete, Kyetare e Komisionit për Punën, Cështjet Sociale dhe Shëndetësinë, Kuvendi i Shqipërisë (TBC)
- 11.00 – 11.10** Mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe krimet seksuale,  
**Znj. Elona Gjebrea**, zv. Ministre e Punëve të Brendshme dhe Koordinatore Kombëtare e Luftes kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore
- 11.10 – 11.40** Drejt një Regjistri Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Krimet Seksuale në Shqipëri
- **Znj. Mersila Ballo**, CRCA Shqipëri & **Z. Mirgit Vataj**, ALO 116
  - **Znj. Tidita Fshazi**, Experte Ligjore
- 11.40 – 12.00** Pyetje/Diskutime
- 12.30** Konkluzione / Rekomandime  
Mbyllja e Workshop